

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS – kolegji i përberë nga gjyqtarët: Hashim Çollaku, kryetar i kolegjit, Gani Zabeli dhe Ferit Osmani, anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtarit ligjor Bajram Cacaj, në çështjen penale kundër të akuzuarit I.B., nga fshati ... Komuna e Mitrovicës, për shkak të veprës penale Vjedhje e pyllit në vazhdim nga neni 358 par. 2 e lidhur me nenin 81 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), duke vendosur përkitazi me ankesën e Prokurorit të Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë, P.nr.164/2019, të datës 15.05.2019, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 02.09.2019, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e Prokurorit të Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, kurse aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë, P.nr.164/2019, të datës 15.05.2019, **vërtetohet**.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Mitrovicë, me aktgjykimin P.nr.164/2019, të datës 15.05.2019, të akuzuarin I.B., e ka shpallur fajtor për veprën penale Vjedhje pylli në vazhdimësi nga neni 358 par. 2 lidhur me nenin 81 të KPRK-së, dhe e ka gjykuar me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti dhe me dënim me gjobë në shumë prej 400 (katërqind) € të cilat dënime nuk do të ekzekutohen nëse i akuzuari nuk kryen vepër tjetër penale në kohëzgjatje prej 2 (dy) viteve. Është obliguar i akuzuari që në emër të shpenzimeve procedurale-paushallit gjyqësorë të paguaj shumën prej 20 euro si dhe në emër të fondit për kompensimin viktimave shumën prej 30 euro, të cilat shpenzime i akuzuari është i obliguar që t'i paguaj në afatin prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit. Pala e dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore juridike - kompensimin e dëmit është udhëzuar në kontest të rregullt civil.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor ankesë ka paraqitur Prokurori i Prokurorisë Themelore në Mitrovicë dhe atë për shkak të vendimit lidhur me sanksion penal, me propozimin që ankesa të aprovet si e bazuar, aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet dhe ndaj të akuzuarit të shqiptohet një dënim më burgim efektiv.

Prokurori i Apelit me parashtresën me shkrim PPA/II.nr.1014/2019, të datës 19.08.2019, ka propozuar që të aprovohet si e bazuar ankesa e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet dhe ndaj të akuzuarit të shqiptohet një dënim me burg efektiv.

Gjykata e Apelit pasi shqyrtoj të gjitha shkresa e kësaj çështje juridiko-penale, studioj aktgjykimin e ankimuar në pajtim me dispozitat e nenit 394 të KPP-së, dhe pasi vlerësoj pretendimet e cekura në ankesë, gjeti se:

Ankesa nuk është e bazuara.

Edhe pse aktgjykimi i shkallës së parë nuk ankimohet për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, më gjithë atë Gjykata e Apelit të njëjtin sipas detyrës zyrtare e shqyrtoj edhe në këtë aspekt, konform dispozitës se nenit 394 të KPP-së dhe konstatoj se ai nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, e të cilat kishin me kushtëzuar anulimin e tij, si dhe as shkelje të Ligjit Penal në dëm të akuzuarit.

As gjendja faktike nuk ka qenë objekt vlerësimi i kësaj gjykate, ngase as në ankesë nuk ka mundur të kontestohet sepse i akuzuari në shqyrtimin gjyqësor e ka pranuar fajësinë për të gjitha pikat e akuzës, edhe gjykata është pajtuar me një pohim të tillë, prandaj, sipas nenit 383 par. 2 të KPPK-së, ndaj aktgjykimin që është marrë në bazë të pranimit të fajësisë ose marrëveshjes për pranimin e fajësisë nuk lejohet ankesa për gjendjen e fakteve, aktgjykimi i ankimuar u vlerësua vetëm në frymën e pretendimeve ankimore.

Sa i përket vendimit për dënim, më ankesë Prokurori pretendon se gjykata e shkallës së parë gjatë matjes së dënimit është dashtë të ketë parasysh se vepra është kryer më qëllim dher se e dëmtuara është vlerë e mbrojtur, përkatësisht pyll i shtetit. Gjykata nuk ka marrë parasysh dënueshmërinë e veprës penale për të cilën i akuzuari është shpall fajtor, është dashtë të merret parasysh se i akuzuari gjatë një periudhe të gjatë kohore ka kryer vepër penale në pyllin e shtetit, se dëmi material është i madh, veprat penale të tilla janë në rritje, andaj politika e ndëshkimi është e butë dhe për këtë arsye duhet të shqiptohen dënime më të ashpra që të ndikojnë të tjerët të mos kryejnë vepra penale. Thekson se i akuzuari është recidivist, e cila është rrethanë veçanërisht rënduese, shton se gjykata ka marrë parasysh vetëm rrethanat lehtësuese dhe se ato rënduese nuk i ka vlerësuar sikurse duhet dhe për këtë shqiptoj dënim të lehtë, më të cilin dënim nuk do të arrihet as qëllimi i dënimit, andaj ka propozuar që të shqiptohet një dënim më burg efektiv.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit pretendimet ankimore të Prokurorit për shqiptimin e një dënimi më burg efektiv, nuk janë të bazuara. Gjykata e shkallës së parë me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit i ka vlerësuar të gjitha rrethanat relevane në kuptim të dispozitave ligjore, ku si rrethana rënduese ka vlerësuar shkallën e përgjegjësisë

penale dhe rrethanat në të cilat është kryer vepra penale, ndërsa si rrethana lehtësuese ka vlerësuar ka vlerësuar rrethanat personale të kryerësit dhe sjelljen e tij pas kryerjes së veprës penale, pranimin e fajësisë, i cili pranim për gjykata shpreh një pendim të thellë, se në të dhënat dhe shkresat e lëndës nuk rezulton se i akuzuari të jetë dënuar ndonjëherë për ndonjë veprë penale me ndonjë aktgjykim, ka vlerësuar gjendjen e dobët ekonomike dhe është rast social, në prani të cilave rrethana i ka shqiptuar dënimin si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar.

Vlerësimin e këtillë të rrethanave relevante për matjen e dënimit, e pranon edhe kjo gjykatë, dhe gjen se në praninë e rrethanave të vlerësuara nga gjykata e shkallës së parë, nuk ka vende për shqiptimin e një dënimi më burg efektiv. Prandaj, duke marr parasysh rrethanat të cilat i ka konstatuar dhe vlerësuar gjykata e shkallës së parë, si dhe duke marrë parasysh se në ankesën e Prokurorit nuk theksohet ndonjë rrethanë e re rënduese, e cila nuk ka qenë objekt vlerësimi i gjykatës së shkallës së parë dhe e cila kishte me justifikuar shqiptimin e një dënimi më burg efektiv, Gjykata e Apelit vlerëson se dënimi i shqiptuar të akuzuarit si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar është në harmoni me intensitetin e rrezikshmërisë shoqërore të veprës së kryer penale dhe me shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit si ekzekutor dhe se ky dënim duhet t'i shërbej preventivës gjenerale, posaçërisht asaj individuale, forcimit të moralit të shoqërisë si dhe përgjegjësisë dhe disiplinës së qytetarëve dhe se me dënimin e shqiptuar kryerësi do të parandalohet nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, do të bëhet rehabilitimi i tij dhe do të ndikoj në përmbajtjen e personave tjerë nga kryerja e veprave penale, kjo gjykatë konsideron se me dënimin e shqiptuar të akuzuarit nga ana e gjykatës së shkallës së parë do të arrihet qëllimi i ndëshkimit i paraparë me dispozitat e neni 41 të KPRK-së.

Nga sa u tha më lartë dhe në bazë të nenit 401 të KPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS

PA1.nr.998/2019 datë 02.09.2017

Zyrtari ligjor:

Bajram Cacaj

Kryetari i kolegjit:

Hashim Çollaku

Anëtarët e kolegjit:

Gani Zabeli

Ferit Osmani